




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**



Vendim

Nr. 73 Date : 25/10 2019

Për dhënie pëlqimi për kalimin e të drejtës së pronësisë për efekt legalizimi të parces ndërtimore në posedim të z.Sami Kamber Zagani.

Nisur nga kërkesa e Agjencise Shtetërore të Kadastres, Drejtoria Shkoder, me nr. Prot. 3251 date 15.07.2019 si dhe referuar ligjit 9482 datë 3.4.2006 " Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve informale" ndryshuar, neni 15/1 pika 2, VKM nr 465 date 22.06.2016 " Për Përcaktimin e Proedurave dhe Rregullave për Kalimin e së Drejtes së Pronësisë mbi Parcelen Ndërtimore të Objekteve Informale" pika 19 ku citohet se:

Kërkesa për miratim nga bashkia kompetente, sipas pikës 2, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, paraqitet nga drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t, përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe masës e vlerës së kompensimit financiar. Kjo kërkesë paraqitet për të gjitha parcelat ndërtimore në pasuritë e transferuara në pronësi të bashkisë, brenda territorit të njësisë administrative përbërëse.

Kërkesa merret në shqyrtim nga këshilli bashkiak, i cili duhet të vendosë për miratimin e tjetërsimit, duke nxjerrë pasuritë (ose pjesë të tyre) nga inventari i pronave të bashkisë.

Kur bashkia ka vetëm të drejta administrimi mbi pasurinë, ajo njoftohet për faktin e kalimit të pronësisë përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, me qëllim nxjerrjen e pasurisë (ose pjesës së saj) nga inventari i pronave të bashkisë.

Si dhe mbeshetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqerisjen vendore", neni 54, 55, ndryshuar.

Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumice te cilesuar te votave,

VENDOSI

- Ti jepet pelqim Agjencise Shteterore te Kadstres, Drejtoria Shkoder per kalimin e se drejtes se pronesise te siperfaqes prej **128.3 m2** te parces ndertimore te z. Sami Kamber Zagani, pjese e pasurise nr. **536/5**, ndodhur ne ZK **1329** , Nj.A. Bushat, Bashkia Vau Dejes, pasuri e cila eshte kaluar ne pronesi ish Komunes Bushat me VKM 68 dt. 28.01.2008.
- Pasuria me nr 536/5 eshte certifikuar me dt 15.10.2010 me pronar Komuna Bushat, me siperfaqe totale 3285 m2 , lloji truall, (bashkelidhur certifikate dhe harta treguese e regjistrimit).

- Pasuria 536/5, në Planin e Përgjithshëm Vendor, bënë pjesë në njësinë Strukturore BU-UB-234. Njësi Urbane qendrore, me përdorim kryesisht banim dhe shërbime. Ndërhyrjet në këtë njësi duhet të respektojnë karakterin ekzistues, si dhe të konsolidojnë indin urban të njësisë. Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve Publike, shpreh dakortsinë me cdo ndërhyrje dhe/ose tjetërsim, që nuk bie ndesh me ato të specifikuara në njësinë stukturore të hartuar në Planin e Përgjithshëm Vendor.
- Bashkëlidhur flete inventari, njesia strukturore BU-UB-234

➤ Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve Publike, Sektori i Privatizimeve dhe Aseteve per zbatimin e vendimit.

- Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"(ndryshuar)
- Ky Vendim u shpall sot me datë 29/10/2019.

SEKRETAR
ARDIAN ÇELEPIJA



KRYETAR
MARK BISHA

